

**Vendim nr. 232 datë 16.10.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 23 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **ERMAL ALLA**

**OBJEKTI:** **Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr. 167, datë 17.07.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 134, pika 1, shkronja “i”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 80 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Me kërkesën e datës 30.05.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, me objekt: “*Shfuqizimin e akteve të pushtetit publik, datë 25.01.2024, 29.01.2024, 05.02.2024 dhe 09.02.2024, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, duke pretenduar cenimin e së drejtës së pronës private dhe të parimit të mosdiskriminimit.

2. Me vendimin nr. 167, datë 17.07.2024, Kolegji i Gjykatës (Kolegji) ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotësonte një nga kriteret paraprake, atë të shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion. Kolegji ka arsyetuar se për pretendimet në lidhje me aktin noterial të shitjes së datës 30.03.2001, kërkuesi ka marrë përgjigje me vendimin nr. 232, datë 08.11.2023 të Kolegjit, me të cilin është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, për shkak të mosplotësimit të kriterit paraprak të shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, ndërkohë që ai edhe pas kësaj nuk del të ketë ndërmarrë veprime për ngritjen e pretendimeve përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të drejtën e pronësisë që pretendon se i është cenuar. Ndërsa për pretendimet në lidhje me aktet dhe mosveprimet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), kërkuesi nuk ka përdorur mjetet ligjore administrative dhe ato gjyqësore në dispozicion dhe as ka arritur të argumentojë se përse paraqitja e ankimit kushtetues individual është mjeti i vetëm efektiv në dispozicion të tij për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë cenuar.

3. Në datën 27.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 167, datë 17.07.2024 të Kolegjit.

## II

### **Pretendimet e kërkuesit**

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se në vendimin e Kolegjit faktet e pasqyruara nuk përkojnë me faktet e paraqitura në ankimin e tij, të cilat janë shtrembëruar, duke shmangur thelbin e ankimit që është refuzimi i zbatimit të ligjit me mosveprim nga ASHK-ja, se pretendimet e tij në ankim janë përmbledhur në vendim në pak rreshta dhe ato nuk janë marrë

plotësisht në konsideratë, si dhe se Kolegji duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë plenare për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve të paligjshme të ASHK-së.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkesit

5. Neni 133, pika 1, i Kushtetutës parashikon se pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj. Ndërkohë, neni 31 i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se çdo ankim kushtetues individual i nënshtrohet shqyrtimit paraprak nga Kolegji i Gjykatës, i cili vlerëson nëse ankimi përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji për kalimin e çështjes në seancë plenare. Ky ligj dhe Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja*), kanë parashikuar më tej rregullat e detajuara të procedurave të gjyqimit kushtetues, duke parashikuar në dispozita të posaçme edhe kërkesat/ankesat ndaj vendimeve të gjyqimit kushtetues. Në kuptim të këtyre parashikimeve, një prej rasteve në të cilat mund të vihet në lëvizje Gjykata për të shqyrtuar vendimmarrjet e saj, është kur kërkohet saktësimi dhe plotësimi i vendimit me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80 i ligjit nr. 8577/2000*). Ky parashikim është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose ndreqet për gabime në shkrim ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në to.

6. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 167, datë 17.07.2024 të Kolegjit, duke pretenduar se faktet e pasqyruara në vendim nuk përkojnë me faktet e paraqitura në ankimin, të cilat janë shtrembëruar, duke shmangur thelbin e ankimit që është refuzimi i zbatimit të ligjit me mosveprim nga ASHK-ja, si dhe se pretendimet e tij në ankim janë përmbledhur në vendim në pak rreshta dhe ato nuk janë marrë plotësisht në konsideratë. Po kështu, kërkuesi pretendon se Kolegji duhej ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë plenare për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve në kundërshtim me Kushtetutën dhe në cenim të rendit juridik nga ana e ASHK-së.

7. Në lidhje me pretendimin në kërkesën e kërkuarit se faktet e pasqyruara në vendim nuk përkojnë me faktet e paraqitura në ankimin e tij, të cilat janë shtrembëruar duke shmangur thelbin e ankimit që është që refuzimi i zbatimit të ligjit me mosveprim nga ASHK-ja, Kolegji vëren se kërkuari nuk ka parashtruar ndonjë argument ose të dhënë konkrete, nga e cila të rezultonte se faktet e pasqyruara në vendim të mos jenë në përputhje me aktet shkresore të depozituara nga kërkuari bashkë me ankimin kushtetues individual. Nga ana tjetër, Kolegji çmon të theksojë se pasqyrimi në vendim i fakteve është i ndryshëm nga interpretimi i tyre në kuadër të vlerësimit të pretendimeve në ankimin kushtetues individual, ndaj pretendimi në kërkesën e kërkuarit në fakt duket se ka të bëjë me thelbin e vendimmarrjes së mëparshme të Kolegjit.

8. Për sa i përket pretendimit në kërkesën e kërkuarit se pretendimet e tij në ankimin kushtetues individual janë përmbledhur në vendimin e Kolegjit vetëm në pak rreshta dhe ato nuk janë marrë plotësisht në konsideratë, Kolegji vëren se ky pretendim nuk tregon për ndonjë mungesë saktësie ose mangësie në atë vendim, por duket se ka të bëjë me thelbin e vendimmarrjes së mëparshme të tij.

9. Për pretendimin në kërkesën e kërkuarit se ankimi kushtetues individual duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare për shkak të veprimeve dhe mosveprimeve në kundërshtim me Kushtetutën dhe në cenim të rendit juridik nga ana e ASHK-së, Kolegji vëren se ky pretendim qartazi lidhet me thelbin e vendimmarrjes së mëparshme të tij.

10. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkesa e paraqitur për saktësimin dhe plotësimin e vendimit të tij nr. 167, datë 17.07.2024, në thelb, ka të bëjë me mënyrën e vlerësimit nga Kolegji të pretendimeve të parashtruara nga kërkuari në ankimin e tij kushtetues individual të datës 30.05.2024, pra nuk kanë të bëjnë me ndonjë prej rasteve të parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577/2000 dhe në nenin 43 të Rregullores, domethënë për gabime në shkrim, në llogari ose pasaktësi të vendimit.

11. Për rrjedhojë, në rrethanat kur pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me mënyrën se si Kolegji ka vlerësuar ankimin e tij kushtetues individual (fillestar), për sa kohë vendimet e Gjykatës nuk mund të bëhen objekt kontrolli ose rishikimi as nga vetë ajo, përveç rasteve të përcaktuara në mënyrë të shprehur në nenet 71/c dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000, dhe në kushtet kur kërkuari nuk

ka argumentuar dhe provuar se ndodhet para ndonjërit prej këtyre rasteve, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me një kërkesë të tillë.

12. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.